



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 94/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërjez. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Sinjal” SH.P.K. - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.N.T. “EingCom” & N.T.SH. “Ekoinvest” – Podujeve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, më datën 27.03.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Sinjal” SH.P.K. - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Sinjal" SH.P.K. - Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:02.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:10.08.2018

Njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar dt:22.00.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt:27.02.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 01.03.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Sinjal" SH.P.K. – Ferizaj, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.03.2019 me nr. 94/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit", me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. si dhe
- Nenin 39 i RrUOPP-se

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.13.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të

palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:15.03.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - "Komuna Lipjan", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: "Sinjal" shpk- Ferizaj, ka parashtruar ankesë pas ri vlerësimit (2) të ofertave, kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsytimit të eliminimit ku AK, tekstualisht ka potencuar:

"1- Specifikimi teknik-profesional, pika 4, autorizimet dhe katalogët ju keni ofruar autorizime dhe katalogë nga tri kompani të ndryshme gjë që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit sepse keni ofruar variante të ndryshme për produkte të njëjta, ndërsa sipas pikës 4.1, të FDT-s specifikohet se variantet nuk autorizohen. Dokumentet e ofruara në këtë formë krijojnë konfuzion se nga cili prodhues do të furnizoni nëse do ti epet juve kontrata.

2- Nuk keni ofruar dëshmi mbi plotësimin e karakteristikave të parametrave teknike të kërkuara në detaje teknike të reflektorit LED, karakteristikat teknike të dritave sinjalizuese LED –vezulluese dhe karakteristikat teknike të shtyllave gjysmë portale dy kahesh.

3- Autorizimi që keni ofruar nga DETAS nuk është i vulosur, ndërsa të operatorët tjerë ky dokument është i vulosur – dyshohet në vërtetësinë e këtij dokumenti". Rrjedhimisht eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha pretendimet ankimore janë trajtuar nga eksperti teknik, pasi që i njëjti të gjitha shkresat e lëndës deri në datën e protokollimit / dorëzimit të këtij raporti i ka pasur në posedim.

Fillimisht po sqarojmë se disa nga pretendimet ankimore që lidhën me arsytimin e eliminimit si dhe kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të ri rekomanduar për dhënie janë trajtuar përmes raporteve paraprake, rrjedhimisht paneli shqyrtues përmes vendimeve të datës 26.09.2018, me nr. 458/18, dhe 07.02.2019 me nr. 730-18 i ka trajtuar dhe ka vendosur, prandaj ri trajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara nga paneli shqyrtues, paraqet mos respektim të nenit 16, të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017.

Eksperti teknik sqaron se pretendime ankimore të reja kryesisht kanë të bëjnë kundër arsytimit të eliminimit të potencuar në sqarimin hyrës të këtij raporti, rrjedhimisht pikën e parë të arsytimit të eliminimit e kualifikojmë si të bazuar, pasi që parashtruesi i ankesës ka dorëzuar katalogë dhe autorizime nga kompani të ndryshme mirëpo jo vetëm për njërin produkt. Shembull: Në katalogun e kompanisë TAMBURINI janë të paraqitur semaforët mobil ose të lëvizshëm për drejtimin e komunikacionit, e po të njëjtit janë paraqitur edhe në katalogun e kompanisë DETAS SPA,

rrjedhimisht janë paraqitur dy variante për të njëjtin produkt, përderisa në dosjen e tenderit nuk kanë qenë të autorizuar variantet.

Poashtu arsyetimin nr.2, të eliminimit e kualifikojmë si të bazuar, për kundër asaj që parashtruesi i ankesës ka ofruar deklaratë me shkrim se i plotëson të gjitha karakteristikat teknike të detyrueshme, në katalogët e prezantuar në ofertë nuk argumentohen karakteristikat teknike të detajuara të reflektorit LED, të dritave sinjalizuese LED- vezulluese, si dhe shtyllave dy kahesh, siç është kërkuar tek njoftimi për informata shtesë ose përmirësimi i gabimit, të datës 03.08.2018, të publikuar në ueb faqen e KRPP-së.

Përderisa lidhur me pikën nr. 3, të arsyetimit të eliminimit, ku AK ka potencuar se: “Autorizimi që keni ofruar nga DETAS nuk është i vulosur, ndërsa te operatorët tjerë ky dokument është i vulosur – dyshohet në vërtetësinë e këtij dokumenti”, sqarojmë se paneli shqyrtues përmes arsyetimit të vendimit të fundit të datës 07.02.2019, me nr. 730/18, përveç tjerash ka kërkuar nga AK / Komuna Lipjan që të kërkoj sqarime shtesë nga operatorët ekonomik, përderisa sipas shkresave të lëndës që kishim në posedim rezulton që për këtë çështje AK, nuk ka kërkuar ndonjë sqarim shtesë lidhur me këtë çështje, rrjedhimisht nuk i ka zbatuar në tërësi rekomandimet e dala nga i njëjti vendim, prandaj këtë pikë të eliminimit e kualifikojmë si të pa bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të ri rekomanduar për dhënie të kontratës sqarojmë se tani në shkresa të lëndës së të njëjtit operator ekonomik ekziston deklarata mbi specifikacionet teknike të detyrueshme, megjithatë paneli shqyrtues përmes arsyetimit të vendimit të datës 07.02.2019, me nr. 730/18, shprehimisht ka potencuar se, i njëjti operator ekonomik, nuk ka paraqitur deklaratën mbi specifikacionet teknike. Përderisa lidhur me certifikatën e zinkimit, AK/ Komuna Lipjan përmes ri vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë dhe operatori ekonomik i rekomanduar ka prezantuar certifikatën e zinkimit me afat. Përderisa lidhur me certifikatën e A- testit sqarojmë se, certifikata e A-testit është e lëshuar në emër të anëtarit të grupit/konzorciumit “Ekoinvest”NTSH, rrjedhimisht si e tillë eplotëson kërkesën e AK-s, të përcaktuar në dosje të tenderit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon i panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues “Sinjal”shpk – Ferizaj të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të **anulohet** në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme dhe lënda të RI – TENDEROHET, nëse AK/Komuna Lipjan, ka ende interes për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik përmes parashtrësës me shkrim të datës: 18.03.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.03.2018, ku kanë qenë prezent Paneli shqyrtues, përfaqësuesi, i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. L. Bajraktari deklaroi: Ne konsiderojmë se raporti i ekspertit nuk trajton plotësisht ne nuk pajtohemi me përgjigjen në pretendimin ankimor nr 1 ku eksperti shqyrton se vendimi i AK-se është i bazuar për arsye se ne i kemi ofruar 2 autorizime, fillimisht dua të caktoj që paramas janë disa lloje të ndryshme të produktit dhe ne kemi një autorizim nga kompania TAMBURINI për shenja të komunikacionit ndërsa kemi edhe të kompanisë DETAS POWER nga Italia për panelet ndriçuese dhe eksperti ka thënë se edhe në katalogun e tamburinit ka panele ndriçuese mirëpo në dëshiroj të theksojmë se në katalogun e TAMBURINIT e kemi dorëzuar origjinal ashtu siç është pa shtuar e pa hekur ndonjë produkt mirëpo autorizimi është për shenja të komunikacionit. Gjithashtu eksperti ka konkluduar se për dritat vezulluese LED nuk argumentohen karakteristikat teknike të detajuara, ne nuk pajtohemi me këtë pasi ne i kemi ofruar katalogët me specifikacione të detajuara si dhe certifikatat e kompabilitetit EN siç janë kërkuar në specifikat teknike. Gjithashtu sa i përket një pretendimi të AK se autorizimi i kompanisë DETAS POWER se nuk është origjinal respektivisht i vulosur ku edhe eksperti e ka aprovuar si pretendim të bazuar. Ne pas vendimit të OSHP-së me nr 730/18 kemi kërkuar nga prodhuesi që të na i dërgoj me post Autorizimin origjinal ashtu siç e ka kërkuar AK-ja ku edhe para panelit i ofrojmë autorizimin nga prodhuesi OSHP- e ka autorizuar AK me kërkuar sqarime shtesë mirëpo AK nuk ka kërkuar informata shtesë nga ne. Vlen të theksojmë që ky autorizim është ka DETAS e cila selinë e ka në Itali ndërsa OE i rekomanduar për kontratë e ka autorizimin e DETAS nga një distributor Kroat. pra ne do të ofrojmë AK-se të njëjtat produkte me të njëjtat spec, pasi i kemi të dytë autorizimet e të njëjtës kompani mirëpo dallimi i vetëm është në çmim ku AK në ofertën tonë do të kursente 21.660 euro pasi që ne jemi oferta e 2 të me e lire. Gjithashtu një pikë tjetër është se ne kemi kërkuar në kërkesën tonë për rishqyrtim të AK që ta rishqyrton vendimin e saj të kontratës EING COM për faktin se konsiderojmë se ky OE nuk i plotëson kushtet dhe kërkesës se përshtatshmërisë të kërkuar në DT. Tek dokumenti bankar që është kërkuar të kapaciteti financiar në ofertën e tyre OE EING COM ka dorëzuar një dokument bankar të pavulësuar. Konsiderojmë se AK ka përdoruar standarde të dyfishta nuk ka bërë trajtim të

barabartë nuk e ka përfill nenin 7. Gjithashtu në qasje të dokumenteve kemi vrejtur se OE i rekomanduar nuk e ka pas deklaratën mbi specifikacioneve ndërsa në raportin ku na kanë dërguar neve dyshojmë se e kanë futur pas hapjes se ofertave.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Ramadani deklaroj: Sa i përket katalogëve dhe autorizimeve është e vërtetë se prej ankesës se pare kanë qenë 2 katalogë të njëjta që është vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues dhe ekspertët ku e dimë që në DT nuk lejohen variante të ndryshme dhe AK nuk ia mundëson ligji me kërkuar sqarime shtese ku kjo lëndë nuk i plotëson kushte dhe OE nuk mundet me kalu. Pika 2 sa i përket deklaratës se specifikimeve ju garantoj se është pjesë e DT, është me nr rendor që nuk ka pas mundësi të futet pas hapjes së dosjes të ofertave, Sa i përket dokumentit bankar ka qenë origjinal por jo i vulosur kemi kërkuar sqarime edhe nga banka edhe na OE dhe e kanë konfirmuar që është lëshuar nga banka por kanë harruar të vulojnë. Nuk pajtohem që lënda të shkojë në ritenderim kërkoj që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, Propozoj që të refuzohet ankesa e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së eventualisht nëse ritenderohet i humbim mjetet donacionin nga organizata zvicerane.

Gjatë prezantimit në seancë Përfaqësuesi i EING COM deklaroi: sa i përket se a është i përgjegjshëm OE Sinjal apo jo kjo është cek në vendimin e datës 26.09.2018 vendimi nr 458/18 ndërsa sa i përket deklaratës së specifikacioneve teknike eksperti shqyrtues në vendimin paraprak e ka marrë për bazë deklaratën e themelimit të grupit dhe nuk e ka marrë deklaratën e kompatibilitetit të specifikacionit teknike Aneksi 1 faqe 39 për të vërtetuar këtë mundëmi të hapim edhe kopjen fizike. Kërkoj nga paneli shqyrtues që ta hedh poshtë ankesën e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bibaj deklaroj: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër arsyetimit të eliminimit si dhe kundrejt OE të rekomanduar të njëjtat pretendime janë trajtuar nga eksperti teknik dhe në bazë të shqyrtimit ka rezultuar që për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme, prandaj është propozuar që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi. Pra arsyetimi i eliminimit është pjesërisht i bazuar kundrejt parashtruesit të ankesës ndërsa kundrejt Ofertës së OE të ripropozuar për dhënie përmes vendimit paraprak të OSHP-së është konstatuar se i njëjti OE nuk ka paraqitë deklaratën mbi specifikat teknike dhe kemi propozuar që ankesa të jetë si e bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkoj që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në prani të palëve paneli shqyrtues pas ekzhaminimit të ofertës në prani të gjitha palëve konstaton se gjendet deklarata e kompatibilitetme specifikacionet teknike të aneksit 1 të datë 10.08.2018.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, dhe ekspertin të jashtëm teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, për të vërtetuar gjendjen faktike në prani të palëve paneli shqyrtues pas ekzhaminimit të ofertës se OE të rekomanduar për dhënie të kontratës në prani të gjitha palëve konstaton se gjendet deklarata e kompatibilitet me specifikacionet teknike të aneksit 1 të datë 10.08.2018.

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e dhëna nga ana e eksperti teknik konstaton se pika e parë e arsytimit të eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së është e qëndrueshme, pasi që parashtruesi i ankesës ka dorëzuar katalogë dhe autorizime nga kompani të ndryshme mirëpo jo vetëm për njërin produkt. Shembull: Në katalogun e kompanisë TAMBURINI janë të paraqitur semaforët mobil ose të lëvizshëm për drejtimin e komunikacionit, e po të njëjtit janë paraqitur edhe në katalogun e kompanisë DETAS SPA, rrjedhimisht janë paraqitur dy variante për të njëjtin produkt, përderisa në dosjen e tenderit nuk kanë qenë të autorizuar variantet.

Paneli shqyrtues konstaton se është i bazuar edhe arsytimin nr. 2, i eliminimit të OE ankues, nga ana e AK-së për faktin se për kundër asaj që parashtruesi i ankesës ka ofruar deklaratë me shkrim se i plotëson të gjitha karakteristikat teknike të detyrueshme, në katalogët e prezantuar në ofertë nuk argumentohen karakteristikat teknike të detajuara të reflektorit LED, të dritave sinjalizuese LED- vezulluese, si dhe shtyllave dy kahesh, siç është kërkuar tek njoftimi për informata shtesë ose përmirësimi i gabimit, të datës 03.08.2018, të publikuar në ueb faqen e KRPP-së.

Paneli shqyrtues lidhur me pikën nr. 3, të arsytimit të eliminimit të OE ankues, ku AK ka potencuar se: “Autorizimi që keni ofruar nga DETAS nuk është i vëltur, ndërsa të operatorët tjerë ky dokument është i vëltur – dyshohet në vërtetësinë e këtij dokumenti”, sqarojmë se Paneli shqyrtues përmes arsytimit të vendimit të fundit të datës 07.02.2019, me nr. 730/18, përveç tjerash ka kërkuar nga AK / Komuna Lipjan që të kërkoj sqarime shtesë nga operatorët ekonomik, përderisa sipas shkresave të lëndës që kishim në posedim rezulton që për këtë çështje AK, nuk ka kërkuar ndonjë sqarim shtesë lidhur me këtë çështje, rrjedhimisht nuk i ka zbatuar në tërësi rekomandimet e dala nga i njëjti vendim, mirëpo duke

pas parasysh faktin se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e AK-së të cekura si më lart, andaj për operatorin ekonomik në fjalë edhe sikur te kërkohej sqarim për këtë pike nuk do te ndryshohej asgjë rezultati final sepse operatori ekonomik në fjalë tani më duhet te kualifikohet si palë pa interes për aktivitetin e prokurimit në fjalë, ashtu siç parashihet me nenin 4 paragrafi 1pika 26 të LPP-së sepse i njëjti operator ekonomik është i pa përgjegjshëm dhe se nuk mund te vjen në shprehje për nënshkrim të kësaj kontrate.

Lidhur me pretendimet ankimore kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të ri rekomanduar për dhënie të kontratës sqarojmë se tani në shkresa të lëndës së të njëjtit operator ekonomik ekziston deklarata mbi specifikacionet teknike të detyrueshme, megjithatë paneli shqyrtues përmes arsyetimit të vendimit te datës 07.02.2019, me nr. 730/18, ka thënë se pretendimi i OE ankues është se i njëjti operator ekonomik, nuk ka paraqitur deklaratën mbi specifikacionet teknike dhe paneli shqyrtues ka kërkuar nga AK qe te vërtetohet ky pretendim, te cilen e ka vërtetuar mirëpo edhe ne seancën dëgjimore për shqyrtim kryesor u vërtetua se OE i rekomanduar për kontrate e ka patur ne ofertën e tijë këtë deklaratë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në konstatimet dhe sqarimet e dhëna nga ana e ekspertit teknik-shqyrtues konstaton se lidhur me certifikatën e zinkimit, AK/ Komuna Lipjan përmes ri vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë dhe operatori ekonomik i rekomanduar ka prezantuar certifikatën e zinkimit me afat. Gjithashtu lidhur me certifikatën e A- testit sqarojmë se, certifikata e A-testit është e lëshuar në emër te anëtarit të grupit/ konzorciumit “Ekoinvest”NTSH, rrjedhimisht si e tillë e plotëson kërkesën e AK-së, të përcaktuar në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna e Lipjanit, Lipjan,
- 1x1 OE- “Sinjali” SH.P.K. – Ferizaj
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.


Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi